



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

FAKULTETI I MENAXHIMIT, TURIZËM, HOTELIERI DHE MJEDIS

PUNIM DIPLOME

**ROLI DHE RËNDËSIA E KOMPANISË "TROFTA" PËR TURIZMIN
NË ISTOG**

Mentori:

Prof. Dr. Bedri Millaku

Studentja:

Egzona Zeqiraj

Pejë, 2024

Universiteti "Haxhi Zeka"

Fakulteti i menaxhment, turizem, hotelieri dhe mjedis

Punim diplome

Lënda nga e cila është bërë punimi: Hyrie në turizëm

Tema e punimit: Roli dhe rëndësia e kompanisë “Trofta” për turizmin në Istog

Emri dhe mbiemri i studentit: Egzona Zeqiraj

Statusi i studentit: Student i rregullt

Drejtimi-Departamenti: Menaxhmenti në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis

Shkalla e studimit: Bachelor

Mentori:

Prof. Dr. Bedri Millaku

Pejë, 2024

FALËNDERIME

Jam vërtet i lumtur dhe mirënjohës që kam arritur deri këtu në studimet e mia. Dua të falënderoj familjen time, veçanërisht prindërit e mi që punuan shumë për të më ndihmuar të arsimohem. Gjithashtu, dua të falënderoj profesorin tim, mentorin dhe të gjithë njerëzit që më kanë mbështetur dhe inkurajuar gjatë studimeve të mia.

DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë, Egzona Zeqiraj, jam përpjekur që të sigurojë praktika të mira gjatë kryrjes së punimit dhe se punimi është origjinal në masën e kërkuar, i punuar nga unë pa plagjiaturë, përveç rasteve të cituara dhe të referuara nga literatura e prezantuar në fusnota. Gjithashtu, deklaroj se ky punim nuk është publikuar e as përdorur ndonjëherë në këtë institucion e as në ndonjë institucion tjetër me qëllim për të fituar kredi ECTS.

Emri dhe mbiemri _____

Nënshkrimi i studentit _____

Pejë, me datë: _____

PËRMBAJTJA

Falënderime.....	3
Deklarata e autorësisë.....	4
Lista e figurave.....	7
Abstrakt	8
Abstract.....	9

Kapitulli I

1. Hyrje.....	Error! Bookmark not defined.
1.1. Qëllimi i punimit.....	11
1.2. Objektivat e punimit.....	11
1.3. Metodologjia e punimit.....	12

Kapitulli II

2. Kuptimi i turizmit dhe rëndësia e tij në zhvillimin ekonomik. Error! Bookmark not defined.	
2.1. Kuptimi i turizmit.....	13
2.2. Ndikimi i turizmit në zhvillimin ekonomik.....	14
2.3. Ndikimi i turizmit në performancën e bizneseve.....	16

Kapitulli III

3. Rëndësia e trashëgimisë kulturore në zhvillimin e turizmit.....	17
3.1. Ndikimi i trashëgimisë kulturore në zhvillimin e turizmit kulturor.....	17
3.2. Trashëgimia kulturore si potencial i zhvillimin ekonomik.....	18

Kapitulli IV

4. Zhvillimi i turizmit dhe trashëgimisë kulturore në Komunën e Istogut.....	20
4.1. Historiku dhe karakteristikat e Komunës së Istogut.....	20
4.2. Zhvillimi i turizmit në Komunën e Istogut.....	21
4.3. Trashëgimia kulturore e Komunës së Istogut.....	22

Kapitulli V

5. Turizmi-Studim Rasti “Kompania Trofta”.....	24
5.1. Historiku dhe lokacioni i Kompanisë “Trofta”.....	24
5.2. Aktivitetet dhe veprimtaritë e kompanisë “Trofta”.....	25
5.3. Tregu dhe të arriturat e kompanisë “Trofta”.....	26

5.4. Shërbimet e kompanisë “Trofta”.....	27
Përfundime dhe rekomandime.....	36
Referencat.....	38

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Hotel “Trofta”	27
Figura 2: Hotel “Trofta”	28
Figura 3: Hotel “Trofta”	29
Figura 4: Restaurant “Trofta”	30
Figura 5: Terraca 1 “Trofta”	31
Figura 6: Terraca 2 “Trofta”	31
Figura 7: Terraca 3 “Trofta”	32
Figura 8: Salla e konferencës “Trofta”	33
Figura 9: Kultivimi i Rainbow	34
Figura 10: Kultivimi i Troftës i tëri	35

ABSTRAKT

Kultura e një vendi, apo trashëgimia kulturore e tij luajnë një rol shumë të rëndësishëm në jetën e qytetarëve të atij vendi, të cilat janë shfrytëzuar dhe si të tilla ende ruhen për qëllime të zhvillimit të turizmit dhe ruajtjes së traditave. Në Kosovë, secili regjion ka karakteristikat e veta në të cilën edhe njihet, Istogu njihet si një vend i banuar që nga kohët e lashta dhe me pasuri shumë të larta natyrore, kjo e bënë si vend më unik dhe shumë të vizituar. Një prej arsyeve që ky vend vizitohet është vizita e restaurantit dhe hotelit “Trofta”, e cila është një prej kompanive më me reputacion në Kosovë dhe ndër më të vizituarat në vendin tonë, gjë që merr metitat më të mëdha për zhvillimin e turizmit në Komunën e Istogut.

Në kuadër të këtij punimi është shpalosur një përmbledhje e përgjithshme për tematikën në fjalë, duke filluar nga shpjegimi i konceptit të turizmit, pastaj me të kuptuarit të trashëgimisë kulturore, ndikimin e turizmit në zhvillimin ekonomik të një vendi, të kompanisë. Me fokus të veçantë ka qenë shpjegimi i trashëgimisë kulturore të Istogut, si dhe paraqitja detaje për rëndësinë e restaurantit dhe hotelit “Trofta” në zhvillimin e turizmit në Komunën e Istogut. Në kuadër të kapitullit V janë paraqitur të gjitha pikat që ndërlidhen me “Troftën” duke filluar nga zhvillimi historik i tij edhe deri te shërbimet dhe të arriturat e deri tanishme të “Troftës”. Nga elaborimi i punimi është kuptuar se “Trofta” është një biznes shumë i rëndësishëm në Komunën e Istogut që tërheqë shumë vizitorë vendor dhe ndërkombëtar.

Fjalë kyçe: trashëgimi, kulturë, turizëm, Trofta, Istog

ABSTRACT

The culture of a country, or its cultural heritage, play a very important role in the lives of the citizens of that country, which have been used and as such are still preserved for the purposes of developing tourism and preserving traditions. In Kosovo, each region has its own characteristics in which it is known, Istog is known as a place inhabited since ancient times and with very high natural resources, this made it a more unique and very visited place. One of the reasons why this place is visited is to visit the restaurant and hotel “Trofta”, which is one of the most reputable companies in Kosovo and among the most visited in our country, which takes the biggest steps for the development of tourism in the municipality. of Istog.

In the framework of this paper, a general summary of the topic in question is presented, starting from the explanation of the concept of tourism, then with the understanding of cultural heritage, the impact of tourism on the economic development of a country, of the company. With special focus was the explanation of the cultural heritage of Istog, as well as the presentation of details about the importance of the “Trofta”, restaurant and hotel in the development of tourism in the Municipality of Istog. In the context of chapter V, all the points related to “Trofta”, are presented, starting from its historical development to the services and achievements of "Trout" up to now. From the elaboration of the paper, it is understood that “Trofta”, is a very important business in the Municipality of Istog that attracts many local and international visitors.

Keywords: heritage, culture, tourism, Trout, Istog

KAPITULLI I

1. H Y R J E

Në këtë punim është shpjeguar për rolin dhe rëndësinë e kompanisë “Trofta” në zhvillimin e turizmit në Komunën e Istogut. Për zhvillimin e turizmit të një vendi duhet që të ekzistojë një trashëgimi e larmishme dhe e lashtë që të tërheq sa më shumë vizitorë dhe kjo ndërkohë do të ndikonte në zhvillimin e aktiviteteve të kompanive të atij vendi. Trashëgimia dhe traditat poashtu kanë ndikue që kompanitë të krijojnë ide për kultivime të produkteve dhe shërbimeve duke u bazuar në traditat e atij vendi, gjë që ka ndikue që me qenë unike sa i përket ofrimit të atij shërbimi apo prodhimi dhe për të rritur edhe nivelin e turizmit në vendin përkatës. Turizmi është një fenomen shumë kompleks dhe mund të kuptohet plotësisht vetëm atëherë kur e mendojmë nga aspekti multidisiplinar (Candela & Figini, 2012).

Sot, turizmi është shumë më tepër sesa thjesht zhvillimi i produkteve. Ka të bëjë më shumë me cilësinë, të menduarit depërtues dhe aftësinë për të pasur informacion global rreth teknologjisë, partnerëve, kontakteve dhe reagimit të shpejtë ndaj tendencave globale dhe rajonale. Detyra themelore përpara promovimit të turizmit është të lehtësojë integrimin e komponentëve të ndryshëm në tregtinë e turizmit si pjesëmarrës aktivë në jetën sociale dhe kulturore të vendit. Turizmi duhet të jetë një mjet për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe mirëkuptimin e qytetërimeve të ndryshme dhe një pararojë e paqës (Condratov, 2013). Njohuritë e turizmit kanë parë një evolucion mjaft pozitiv dhe kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve nga degë të ndryshme të dijes, por kuptimet e ndryshme që i atribuohen turizmit nuk janë ngushtuar (Cunha, 2012). Vlera e turizmit është e njohur dhe një fakt i pakontestueshëm si për ekonominë në zhvillim ashtu edhe për ato të zhvilluara. Pavarësisht, tendencave ekonomike dhe paqëndrueshmërisë së tregut, turizmi ka vazhduar të rritet dhe të zhvillohet vlera e tij, që lidhet jo vetëm me zhvillimin ekonomik, por edhe me çështjet socio-kulturore dhe mjedisore (Hooper, 2016).

Trashëgimia në dyzet vitet e fundit është bërë jo vetëm sinonim i monumenteve, artefakteve arkeologjike, kulturës, identitetit rajonal dhe kombëtar, por kuptimi dhe marrëdhënia e saj me turizmin është më e dukshme dhe ka evoluar. Një marrëdhënie e ngushtë midis trashëgimisë dhe turizmit ka përmirësuar, megjithëse ndonjëherë e ndërlikon, zhvillimin e saj. Shumë shohin turizmin dhe trashëgiminë dhe në të vërtetë një marrëdhënie në dukje të natyrshme mes tyre, veçanërisht në drejtim të adresimit të çështjeve me shqetësim mjedisor, kulturor dhe politik (Hooper, 2016).

Hulumtimi dhe promovimi i Trashëgimisë Kulturore, është një temë mjaft aktuale jo vetëm në vendin tonë, por edhe në vende të ndryshme të botës. Trashëgimia Kulturore paraqet një koncept që mundëson një urë lidhëse midis së shkuarës dhe së ardhmes me aplikimin e qasjeve të veçanta në të tashmen. Për shkak të vlerave të bashkangjitura për këto grupe apo shoqëri, trashëgimia kulturore ruhet në të tashmen dhe dhurohet për të mirën e brezave të ardhshëm. Punimi është strukturuar me pesë kapituj. Në kapitullin e parë është paraqitur një hyrje, qëllimi, objektivat dhe metodologjia e punimit, në kapitullin e dytë është pasqyruar koncepti i turizmit, ndikimi i turizmit në ekonominë e një vendi dhe në kompani, në kapitullin e tretë është diskutuar për trashëgiminë kulturore të Istogut dhe rëndësinë e tij në zhvillimin ekonomik të vendit. Në kapitullin e katër është paraqitur një përmbledhje e përgjithshme për Komunën e Istogut, për turizmin në këtë komunë,

1.1. Qëllimi i punimit

Qëllimi i këtij punimi është që të kuptojmë rolin dhe rëndësinë e turizmit dhe trashëgimisë kulturore në zhvillimin ekonomik të një vendi, si dhe më specifikisht është analizuar hotel dhe restorantin “Trofta” dhe ndikimin e tij në ngritjen e turizmit në Komunën e Istogut. Përmes këtij punimi synojmë të njohim rëndësinë e turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore dhe rolin e tyre në zhvillimin kulturor dhe ekonomik, që si të tilla këto duhet që të ruhen, duhet edhe të vihen në dispozicion të turizmit, me qëllim që ato të jenë kontribuese në zhvillim ekonomik të popullsisë lokale, mbase edhe të vendit në tërësi, si perspektivë për të ardhmen, sidomos në Komunën e Istogut.

1.2. Objektivat e punimit

Objektivat e këtij punimi janë:

- Të kuptuarit e konceptit të turizmit;
- Të kuptuarit e rolit dhe rëndësisë së turizmit në zhvillimin ekonomik dhe kulturor të një vendi;
- Të kuptuarit e rolit dhe rëndësisë së turizmit në zhvillimin e një kompanie, nga aspekti ekonomik;
- Paraqitja e trashëgimisë kulturore dhe vlerat e saj në nivel lokal dhe global;
- Rëndësia dhe domdoshmëria e Trashëgimisë Kulturore në zhvillimin ekonomik të Komunës së Istogut;

- Identifikimi i rolit të edukimit në vetëdijësimin dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimit të turizmit në një vend;
- Të identifikojmë rolin dhe rëndësinë e zhvillimit të turizmit të Komunën e Istogut; dhe
- Të kuptojmë rolin dhe rëndësinë e hotelit dhe restaurantit “Trofta” në zhvillimin e turizmit në Komunën e Istogut;

1.3. Metodologjia e punimit

Për t’i dhënë formën e duhur këtij punimi të diplomës баçelor janë пërdorur metoda të ndryshme të gërshetuara njëra me tjetrën, të bazuara kryesisht në disa metoda të kërkimit dhe të hulumtimit shkencor. Për mbledhjen e të dhënave të këtij punimi janë пërdorur burimet sekondare. Për mbledhjen e të dhënave nga burimet sekondare kemi пërdorur literatura të ndryshme që kanë qenë të ndërlidhura me temën përkatëse me fushën e turizmit dhe ndikimin e tij në zhvillimin ekonomik të një vendi.

KAPITULLI II

2. KUPTIMI I TURIZMI DHE RËNDËSIA E TIJ NË ZHVILLIMIN EKONOMIK

2.1. Kuptimi i turizmit

Fjalët “turist” dhe “turizëm” filluan të përdoren në shekullin e 18-të në Britaninë e Madhe. Njerëzit kanë ide të ndryshme se nga vjen fjala “turizëm”, por të gjithë bien dakord se ajo erdhi nga fjala franceze “touriste” dhe u ndryshua në “turist” në anglisht. Kjo fjalë do të thotë dikush që lëviz, udhëton ose shkon në një rreth. Në shekullin e 18-të, të rinjtë e pasur nga klasa e lartë shkonin në udhëtime nëpër Evropë me mësuesit e tyre. Këto udhëtime quheshin “The Tour” ose “Grand Tour” dhe ishin për argëtim, mësim dhe përjetim kulturash të ndryshme.

Tani për tani, turne ose udhëtim quhen kur njerëzit shkojnë me pushime dhe vizitojnë vende të reja. Por në të gjithë botën, ne përdorim fjalën turizëm për të folur kur njerëzit udhëtojnë për argëtim, për të mësuar rreth kulturave të ndryshme dhe për të kaluar një kohë të mirë. Fjala turist u përdor për herë të parë në vitin 1830 nga një francez i quajtur V. Zhakmon në librin e tij “Lettres”. Në një libër tjetër të quajtur Fjalori E. Liters i vitit 1885, u shpjegua për herë të parë termi turist. Thuhej se turistët janë njerëz që shkojnë në vende të tjera për t’u argëtuar dhe kënaqur, zakonisht pasi vizitojnë njerëz nga vendi i tyre. Joffre Dumazdier e përshkruan turizmin me një simbol që ka tre pjesë: desoeuvrenebt, delassement, divetissement. Kjo do të thotë të jesh i lirë nga puna, të relaksohesh dhe të argëtohesh (Doka & Draçi, 2002).

Definicioni universal më i pranuar është ai i shkencëtarëve zviceranë Krafp-Hunziker (1942) për turizmin si fenomen i shoqërisë moderne: “Turizmi është një shumë e raporteve dhe dukurive të cilat janë si pasojë e udhëtimeve dhe qëndrimeve në një vend të huaj, nëse nga këto nuk pasojnë shpërngulje ose të ushtruarit e ndonjë aktiviteti ekonomik”. Ekzistojnë disa nga funksionet kryesore të turizmit siç janë: ekonomike, rekreative (shëndetësore), kulturore, argëtuese, politike, sociale etj (Doka & Draçi, 2002).

Turizmi, në kohën moderne, ka qenë një nga aktivitetet me rritjen më të madhe në botë gjatë viteve 1980 deri në 2000, për sa i përket si shpenzimeve, ashtu edhe gjenerimit të monedhës së huaj. Në afatin e gjatë si turizmi kombëtar dhe ai ndërkombëtar mund të japin një kontribut të¹

¹ Kadiu, E. (2013). *Ekonomi Turizmi*. butimi i dytë, sh.b. “Argeta-LMG”, Tiranë, 176.

madh ndaj një rritjeje ekonomike të punësimit në një destinacion ku mund të kufizohet nga aftësia e për të ofruar mallra dhe shërbime që konsumatori do të konsumojë.²

Sot, turizmi është degë e tretë e rëndësishme për ekonominë në mbarë botën, me të ardhurat vjetore me mbi 300 miliardë dollar, me rreth 500 milion njerëz që marrin pjesë në lëvizjen turistike, me rritje mesatare vjetore prej 5.5 %.³

Në ofertën gjeografiko-kulturore, si element bazë për zhvillimin e turizmit, përfshihet e gjithë trashëgimia materiale dhe shpirtërore e një vendi, e cila vihet në shërbim të turizmit. Në këtë pasuri futen të gjitha objektet historike dhe kulturore të vizitueshme nga turistët, siç janë; objektet arkeologjike, kalatë, kështjellat, monumentet e kulturës, muzeumet, monumentet dhe institucionet kulturore dhe sportive etj.⁴ Pra, turizmi është një ndër aktivitetet më të rëndësishme botërore, i cili përfshin miliona njerëz, një gamë e madhe parash dhe gjeneron punësim në vendet në zhvillim dhe të industrializuara.⁵

Zhvillimi mund të konceptohet në shumë mënyra. Që nga fillimi i tij deri në vitin 1940, zhvillimi ishte i lidhur ngushtë me evolucionin e teknologjisë, modernizimin dhe rritjen ekonomike.⁶ Vlera e turizmit është e njohur dhe është një fakt i pakontestueshëm si për ekonominë në zhvillim ashtu edhe për ato të zhvilluara. Pavarësisht tendencave ekonomike dhe paqëndrueshmërisë së tregut, turizmi ka vazhduar të rritet dhe zhvillohet dhe vlerat e tij lidhen jo vetëm me zhvillimin ekonomik, por edhe me çështjet socio-kulturore dhe mjedisore.⁷ Ekonomia është një aspekt shumë i rëndësishëm që lidhet drejtpërdrejt me mirëqenien dhe zhvillimin social.⁸

2.2. Ndikimi i turizmit në zhvillimin ekonomik

Turizmi është një nga industritë kryesore në botë, që do të thotë që njerëzit udhëtojnë për kënaqësi që nga fillimi i ditës. Vitet e fundit, turizmi është bërë si një nga sektorët me zgjerim më të shpejtë të ekonomisë globale. Turizmi lindi si rezultat i modernizimit dhe kontribuoi ndjeshëm në formësimin e përvojës së modernitetit. Rritja ekonomike dhe zhvillimi i turizmit

² Kadiu, E. (2013). *Ekonomi Turizmi*. butimi i dytë, sh.b. “Argeta-LMG”, Tiranë, 176.

³ Gashi, M. (1986). *Bazat e turizmit*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore (ish-KSAK), Prishtinë, f. 9-20, 42.

⁴ Doka, Dh. & Draçi, B. (2002), vepër e cituar, f.10-11.

⁵ Kadiu, E. (2013). *Ekonomi Turizmi*. butimi i dytë, sh.b. “Argeta-LMG”, Tiranë.

⁶ Richtscheid, K. (2011). *The Use of Cultural Heritage in Economic and Human Development: A Comparison of Built Heritage Projects in Morocco and British Columbia*.

⁷ Hooper, G. (2016), *Heritage And Tourism In Britain And Ireland*. Glasgow (UK): Palgrave Macmillan.

⁸ Avdyli, G. (2022). *Kosovo's Cultural Heritage: Social and Economic Importance*. JMU Scholarly Commons

janë të ndërthurura, prandaj një rritje në ekonominë e përgjithshme do të mbështesë zhvillimin e turizmit.⁹

Turizmi është shfaqur si një nga industritë më të mëdha të shërbimeve në botë me përfitime të konsiderueshme ekonomike dhe mundësi të mëdha të mëdha të fitimeve financiare. Është një nga industritë me rritje më të shpejtë në botë dhe mund të luajë një rol të rëndësishëm në përshpejtimin zhvillimi ekonomik i vendit.¹⁰

Një nga arsyt kryesore pse qeveritë e mbështesin dhe promovojnë turizmin në mbarë botën është se ai ka një ndikim pozitiv në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të atij vendi. Turizmi duhet të gjenerojë punësim dhe të ardhura, të çojë në një bilanc pozitiv pagesat përmes turizmit, të stimulojë sektorët furnizues të turizmit dhe të çojë në një nivel përgjithësisht të rritur të aktivitetit ekonomik në vend. Kështu, turizmi ka ndikim në masën sasiore të përdorur shpesh të zhvillimit ekonomik, produktin e brendshëm bruto (GDP).¹¹ Turizmi global, si një biznes kyç kontribues, i cili ka kontribuar në afërsisht prej 10% të PBB-së globale nëpërmjet mundësive të mundshme të punësimit, zgjerimit të tregjeve të klientëve, inkurajimit të tregtisë së eksportit dhe fitimeve nga shkëmbimet e huaja.¹²

Të ardhurat nga turizmi kanë një lidhje në rritje me ekonominë e vendit dhe në këtë mënyrë mund të ndihmojnë në rritjen ekonomike. Biznesi i zhvilluar globalisht i turizmit nxit rritjen ekonomike me kalimin e kohës, duke mbështetur ekonominë më shumë se sa ishte parashikuar.¹³ Roli i turizmit në rritjen ekonomike mund të vërehet nga disa këndvështrime të ndryshme. Turizmi kontribuon në rritjen e të ardhurave të huaja përmes mekanizmit të shpenzimeve të turistëve në vendin e vizituar. Nëpërmjet lidhjeve të tij të forta prapa dhe përpara, turizmi kontribuon drejtpërdrejt dhe tërthorazi në zhvillimin e vendeve. Kjo mund të demonstrohet duke përdorur logjikën e tranzicionit ku supozojmë se, nëse turizmi kontribuon në rritjen ekonomike dhe rritja ekonomike i kontribuon zhvillimit, prandaj turizmi kontribuon në zhvillim.¹⁴

⁹ Dogru, T., & Bulut, U. (2018). Is tourism an engine for economic recovery? Theory and empirical evidence. *Tourism Management*, 67, pp. 425–34.

¹⁰ Gadve, P. A. (2017). A Study the Impact of Tourism Development on Local Business Community. *International Journal of Research in Management, Economics and Commerce*.

¹¹ Ivanov, S., & Webster, C. (2007). Measuring the Impact of Tourism on Economic Growth. *Tourism Economics*, 13(3), 379–388.

¹² Mansfeld, Y., & Winckler, O. (2008). The role of the tourism industry in transforming a rentier to a long-term viable economy: The case of Bahrain. *Current Issues in Tourism*, 11(3):237–67.

¹³ Marin, D. (1992). Is the export-led growth hypothesis valid for industrialized countries? *Review of Economics & Statistics*, 74(4), pp. 678–88.

¹⁴ Ntibanyurwa, A. (2006). Tourism as a factor of development. *WIT Transactions on Ecology and the Environment*, 97.

2.3. Ndikimi i turizmit në performancën e bizneseve

Turizmi është tani një nga industritë më të mëdha në botë dhe një nga sektorët e tij ekonomik me rritje më të shpejtë. Për shumë vende turizmi shihet si një instrument kryesor për zhvillimin rajonal, pasi stimulon aktivitete të reja ekonomike. Turizmi mund të ketë një ndikim pozitiv ekonomik në bilancin e pagesave, në punësim, në të ardhurat bruto dhe prodhimin, por mund të ketë edhe efekte negative, veçanërisht në mjedis. Rritja e paplanifikuar dhe e pakontrolluar e turizmit mund të rezultojë në një përkeqësim të tillë të mjedisit sa që rritja turistike mund të rrezikohet. Mjedi, duke qenë burimi kryesor i produktit turistik, duhet të mbrohet për të pasur rritje të mëtejshme të turizmit dhe zhvillim ekonomik në të ardhmen. Kjo është veçanërisht e vërtetë për turizmin e bazuar në mjedisin natyror si dhe në trashëgiminë historike kulturore. Turizmi i qëndrueshëm ka tre aspekte të ndërlidhura: mjedisore, sociokulturore dhe ekonomike. Qëndrueshmëria nënkupton qëndrueshmëri, kështu që turizmi i qëndrueshëm përfshin përdorimin optimal të burimeve, duke përfshirë diversitetin biologjik, minimizimin e ndikimeve ekologjike, kulturore dhe sociale dhe maksimizimin e përfitimeve për ruajtjen dhe komunitetet lokale.¹⁵

Një rol të rëndësishëm turizmi e luan në zhvillimin e aktiviteteve dhe performancës së bizneseve. Turizmi krijon zhvillimin e bizneseve dhe performancës së tyre. Turizmi krijon mundësi për bizneset e vogla në aktivitete të ndryshme të biznesit turistik për shkak të kostos së ulët fillestare që hyrja është mjaft e lehtë. Gjithashtu, krijon mundësi të mira për bujqësinë vendase, bizneset e ndërtimit, firmat prodhuese dhe biznesin e lidhur me shërbimet. Akomodimi, zinxhiri ushqimor, objektet sportive, guidat turistike janë të nevojshme në vendin turistik për zhvillimin e turizmit. Ai gjithashtu ofron një tregues të qartë se përpjekjet e qeverive për të promovuar industrinë e turizmit do të kenë një ndikim pozitiv në performancën e bizneseve.¹⁶

¹⁵ Bassey, B. E. (2015). Transforming the Nigeria tourism industry through tourism entrepreneurial development. *African Journal of Business Management*, 9(15), 569-580.

¹⁶ Mukhtar, R. (2019). Toward Socially Sustainable Tourism: The Impact of Tourism on SMEs And Livelihood Development At Tourism Destinations In Bahawalpur Pakistan. *Sustainable Business and Society in Emerging Economies*, 1(1), 43-54.

KAPITULLI III

3. RËNDËSIA E TRASHËGIMISË KULTURORE NË ZHVILLIMIN E TURIZMIT

3.1. Ndikimi i trashëgimisë kulturore në zhvillimin e turizmit kulturor

Qarkullimet turistike në botë dhe në vendin tonë nuk janë vetëm për qëllime rekreative, por kanë në to një përmbajtje kulturore, duke e njohur vizitorin me kulturën e vendit dhe motivet etno-sociale. Vlerat e të dyja kohëve të hershme si ato të lashtësisë janë të pranishme në Kosovë. Ka edhe kultura të ndryshme, të cilat më së miri dëshmojnë nga veshja, folklori, lojërat tradicionale etj. Të gjitha janë vlera të rëndësishme për zhvillimin e turizmit.¹⁷

Kosova edhe pse ka potencial të madh turistik, mungesa e infrastrukturës, politizimi i trashëgimisë kulturore, promovimi i dobët dhe vetëdijësimi i pamjaftueshëm i popullatës për rolin e monumentave të kulturës në zhvillimin ekonomik të vendit, ka ndikuar që turizmi ekonomik në Kosovë të ngec prapa vendeve të tjera në rajon, ajo nuk është promovuar mirë dhe sa duhet para vizitorit të jashtëm dhe vendas. Institucionet për promovimin e kulturës dhe turizmit në Kosovë nuk kanë ndonjë program apo udhërrëfyes të caktuar me harta për t'i orientuar turistët e huaj, nuk kanë programe për vizitë dy apo tri orë, dhe nuk kanë programe turistike për një apo më shumë ditëshe në teritorin e Kosovës, mungesa e specializimit të ciceronëve, edhe pse pas luftës janë formuar agjenci turistike që nuk kanë staf të specializuar, nuk posedojnë as harta orientuese etj.¹⁸

Për ta përmirësuar gjendjen në sektorin e turizmit kulturor nevojitet të bëhet promovimi i sa më shumë i vlerave kulturore dhe natyrore, si dhe arsimimit dhe vetëdijësimit të popullatës për rëndësinë e kësaj dege të ekonomisë. Por, në vitet e fundit, njerëzit kanë filluar të kujdesen dhe të rregullojnë disa gjëra të vjetra që janë të rëndësishme për kultura të ndryshme. Megjithatë, ata nuk kanë bërë mjaftueshëm për t'i bërë këto gjëra interesante për njerëzit që të vijnë dhe të shohin.¹⁹

¹⁷ Reçica, F. & Millaku, B. (2011). *Ekonomia E Turizmit/Tourism Economy*. Prishtina: The Authors.

¹⁸ Reçica, F. & Millaku, B. (2011). *Ekonomia E Turizmit/Tourism Economy*. Prishtina: The Authors.

¹⁹ Halimi-Statovci, D. et al, *vepra e cituar*, 2020, f. 245-249.

3.2. Trashëgimia kulturore si potencial i zhvillimit ekonomik

Zhvillimi mund të konceptohet në shumë mënyra. Që nga fillimi i tij deri në vitin 1940, zhvillimi ishte i lidhur ngushtë me evolucionin e teknologjisë, modernizimin dhe rritjen ekonomike.²⁰ Elementet më karakteristike të trashëgimisë janë elasticiteti dhe dinamizmi. Ajo që e bën trashëgiminë elastike është fakti se në kuptimin e saj më të gjerë ajo përfshin “çdo gjë të trashëguar nga e kaluara” dhe në kuptimin e saj më të ngushtë përfshin atë që ka rëndësi historike dhe kulturore. Përkufizime të tjera e përkufizojnë kulturën si “qëllime bashkëkohore të së kaluarës” ose “ajo pjesë e së kaluarës që ne kemi zgjedhur në të tashmen për qëllime bashkëkohore, qofshin ato ekonomike, kulturore, politike apo sociale”²¹

Vlera e turizmit është e njohur dhe është një fakt i pakontestueshëm si për ekonominë në zhvillim ashtu edhe për ato të zhvilluara. Pavarësisht tendencave ekonomike dhe paqëndrueshmërisë së tregut, turizmi ka vazhduar të rritet dhe zhvillohet dhe vlerat e tij lidhen jo vetëm me zhvillimin ekonomik, por edhe me çështjet socio-kulturore dhe mjedisore.²²

Trashëgimia në dyzet vitet e fundit është bërë jo vetëm sinonim i monumenteve, artefakteve arkeologjike, kulturës, identitetit rajonal dhe kombëtar, por kuptimi dhe marrëdhënia e saj me turizmin është më e dukshme dhe ka evoluar. Një marrëdhënie e ngushtë midis trashëgimisë dhe turizmit është përmirësuar, megjithëse ndonjëherë edhe ndërlikon në zhvillimin e saj. Mes turizmit dhe trashëgimisë më të vërtetë vërehet një marrëdhënie në dukje e natyrshme mes tyre, veçanërisht në drejtim të adresimit të çështjeve me shqetësim mjedisor, kulturor dhe politik.²³

Turizmi i trashëgimisë po rritet më shpejt se çdo në sektor tjetër i industrisë së turizmit, me një numër të madh njerëzish që vizitojnë vendet kulturore dhe historike, dhe shihet si i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe reduktimin e varfërisë në mbarë botën. Turizmi i trashëgimisë i referohet elementeve të prekshme dhe të paprekshme kulturore, historike dhe natyrore të së shkuarës dhe të tashmes, si dhe përdorimit të tyre si burime turistike. Ai përfshin të gjithë elementët kulturorë të prekshëm, të ndërtuar si: kështjellat, ndërtesat historike, katedralet, shtëpitë, muzetë, feramat dhe reliket arkeologjike, si dhe elementët e paprekshëm si: gjuha, festivalet, muzika, feja, ushqimi, etj. Në ditët e sotme industria e trashëgimisë gjithashtu njeh

²⁰ Richtscheid, K. (2011). *The Use of Cultural Heritage in Economic and Human Development: A Comparison of Built Heritage Projects in Morocco and British Columbia*.

²¹ Hall, M., & McArthur, S. (1996). *The Human Dimension of Heritage Management: Different Values, Different Interests, Different Issues*, 2-21.

²² Hooper, G. (2016), *Heritage And Tourism In Britain And Ireland*. Glasgow (UK): Palgrave Macmillan.

²³ Hooper, G. (2016), *Heritage and Tourism in Britain and Ireland*. Glasgow (UK): Palgrave Macmillan.

edhe peizazhe që portretizojnë jetën e njerëzve në familjet e tyre, jetën e minatorit, peshkatarit, fëmijëve, burrave dhe grave.²⁴

Ekonomia është një aspekt shumë i rëndësishëm që lidhet drejtpërdrejt me mirëqenien dhe zhvillimin social. Trashëgimia kulturore është një sektor që duhet t'i kushtohet një rëndësi e veçantë, pikërisht për vlerën e të ardhurave joekonomike. Trashëgimia kulturore kontribuon në rritjen e qëndrueshme përmes bashkimit të modernitetit dhe traditës, dhe përmes një kombinimi krijues të trashëgimisë të së kaluarës me ide novatore që synojnë formësimin e së ardhmes. Trashëgimia shihet kështu si një burim, i cili jo vetëm ruan kujtesën historike, por, nëse përdoret në mënyrë krijuese, mund të sjellë përfitime të ndryshme sociale dhe ekonomike për një sërë palësh të interesuara. Ajo ngre profilin e vendeve duke i bërë ato më konkurruese në botën bashkëkohore dhe shërben një burim frymëzimi për artet bashkëkohore dhe industrinë krijuese.²⁵

²⁴ Timothy, D. J. & Nyaupane, G. P. (2009). *Cultural Heritage And Tourism In The Developing World: A Regional Perspective*. London And New York: Routledge.

²⁵ Greta Avdyli, *Kosovo's Cultural Heritage: Social and Economic Importance*, 2022. JMU Scholarly Commons

KAPITULLI IV

4. ZHVILLIMI I TURIZMIT DHE TRASHËGIMISË KULTURORE NË KOMUNËN E ISTOGUT

4.1. Historiku dhe karakteristikat e Komunës së Istogut

Komuna e Istogut ndodhet në veriperëndim të Kosovës afër zonës kufitare me Malin e Zi, dhe është e lidhur me vargmalin që ngrihet mbi 2000 metra mbi nivelin e detit. Komuna përfshin qytetin e Istogut dhe 51 fshatra. Popullsia llogaritet të jetë 56,000 banorë, nga të cilët shumica janë shqiptarë të Kosovës me më shumë se 2,200 egjiptianë dhe 1,600 boshnjakë. Serbët e Kosovës numërojnë rreth 800 banorë, të cilët kryesisht jetojnë në 7 fshatra (Cërkolez/Crkolez, Osojan/Osojane dhe Llukavci i Thatë/Suvi Lukavac, Muzhevinë/Muževine dhe Zallq/Žač).²⁶ Istogu është një vend që ekziston për një kohë shumë të gjatë. Ndodhet pranë dy lumenjve dhe atje jetonin shumë kohë më parë. Ata kishin mullinj për të bluar drithin dhe punishte për të bërë leshin në rroba. Në vitin 1942 Istogu u bë qytet. Në vitin 1978, Istogut iu dha titulli qytet dhe mori përgjegjësi të reja. Ndodhet në pjesën veriore të vendit të quajtur Dukagjini dhe është i rrethuar nga zona të tjera si Mali i Zi dhe Serbia. Istogu ka një sipërfaqe prej 453.84 km² dhe ka rrugë të mira që i ndihmojnë njerëzit të udhëtojnë lehtësisht në vende të tjera të Kosovës. Istogu është një qytet i qetë pranë disa maleve me një lartësi mbidetare prej 2,155 metrash. Temperatura atje është zakonisht rreth 10.7 gradë Celsius gjatë gjithë vitit. Në korrik, temperatura mund të arrijë deri në 27 gradë Celsius, dhe në janar mund të jetë e ftohtë deri në 10 gradë Celsius. Era mund të jetë shumë e fortë ndonjëherë, duke arritur shpejtësinë deri në 120 km/h për shkak të maleve aty pranë. Istogu është i njohur për burimet e tij ujore dhe peshkun, dhe lidhet me rrugët kryesore që të çojnë në Pejë, Mitrovicë dhe Prishtinë. Qyteti është i fokusuar në përdorimin e burimeve të tij për t'u rritur dhe zhvilluar, duke ruajtur gjithashtu traditat e tij dhe plotësuar nevojat e tregut. Istogu është një vend që rrethohet nga zona të tjera të quajtura Skenderaj, Klina, Peja, Mali i Zi, Serbia dhe Zubin Potok. Ka shumë tokë për bujqësi dhe rritje të bimëve. Një pjesë e tokës është në pronësi të qeverisë dhe një pjesë është në pronësi të individëve. Ka edhe sipërfaqe të mëdha pyjore. Istogu ka gjëra të veçanta nën tokë si një lloj mermeri, ujë të veçantë që është i mirë për larje dhe një lloj qymyri. Ai gjithashtu ka shumë burime ujore si lumenj dhe burime.

²⁶ EU/CoE Support to the Promotion of Cultural Diversity. (2015). Istog-Support to the Promotion of Cultural Diversity Local Economic Development component. PCDK

Në një vend të quajtur Banjë ka ujë të nxehtë që mund të përdoret për shërim. Istogu është një vend i bukur me male, ujë të pastër dhe klimë të këndshme. Njerëzit mund të vizitojnë dhe shijojnë natyrën dhe gjithashtu të bëjnë aktivitete që lidhen me bujqësinë. Istogu njihet edhe si vend me trashëgimi kulturore ku janë identifikuar rreth 28 lokacione arkeologjike (si në Studenicë, Vrellë, Bojnicë dhe Surrigane) dhe ka rreth 72 kulla.²⁷

4.2. Zhvillimi i turizmit në Komunën e Istogut

Bjeshkët e “Bjeshkës së Nemuna” dhe “Mokna”, përfshirë “Bjeshkën e Istogut”, janë të rëndësishme për turizmin e qëndrueshëm në zonë. Turizmi duhet të fokusohet në bukurinë natyrore dhe trashëgiminë kulturore të rajonit, si ujërat termale-minerale, sportet në natyrë, dhe eksplorimi i natyrës dhe historisë. “Bjeshka e Istogut” shquhet për jetën e saj të larmishme bimore dhe shtazore, kullotat për blegtori, terrenet e skijimit, pyjet, dhe atraksione të tjera që e bëjnë atë një vend të mrekullueshëm për zhvillimin e turizmit.

“Bjeshkët e Istogut” kanë shumë bimë të veçanta që mund të përdoren për mjekim. Ata gjithashtu kanë male vërtet të larta dhe pamje të bukura, të cilat janë të shkëlqyera për të luajtur sporte si fluturimi i qifteve dhe ngasja e biçikletave. Por, nuk ka shumë rrugë në zonë, kështu që njerëzit nuk mund t’i përdorin këto burime. Ka lloje të ndryshme turizmi që mund të ndodhin në zonë, si vizita në male, udhëtime nëpër zonë, marrja e trajtimeve të shëndetshme, mësimi i kulturës, eksplorimi i natyrës dhe vizita e fermave me bimë të veçanta.²⁸

Në qytetin e Istogut, ka shumë ndërtesa të vjetra, kulla dhe vende të tjera të rëndësishme historike që mund të tërheqin turistët e interesuar për të mësuar për kulturën dhe historinë e zonës. Organizatat dhe bizneset mund t’i përdorin këto vende për të promovuar turizmin kulturor dhe për të sjellë vizitorë. Një projekt i financuar nga Bashkimi Evropian u realizua për të inkurajuar turizmin përmes këtyre vendeve kulturore, duke krijuar një shteg turistik që njerëzit ta ndjekin. Informacioni rreth këtyre vendndodhjeve jepet gjithashtu në harta dhe tabela për të ndihmuar vizitorët të mësojnë më shumë rreth historisë së zonës. Gjithashtu, është bërë një katalog dhe film dokumentar për të ekspozuar veshjet tradicionale të rajonit dhe për të promovuar turizmin përmes trashëgimisë kulturore të Istogut.²⁹

²⁷ Sejfiqaj, O., Kuqi, B., & Shehu, E. (2023). Tourism and Sustainable Development Opportunities in the Municipality of Istog-Republic of Kosovo.

²⁸ UN-Habitat Kosovo. (2015). Local Environmental Action Plan Istog.

²⁹ UN-Habitat Kosovo. (2015). Local Environmental Action Plan Istog.

Rol të rëndësishëm në zhvillimin e turizmit në këtë vend luan edhe komuna. Përmes një plani zhvillimor 2018-2026, komuna ka paraqitur objektivat e këtij zhvillimi, të cilat duhet të bëhen në kuadër të një plani për zhvillimin afatgjatë të komunës, kjo do të thotë të kuptojmë se çfarë duam të arrijmë në të ardhmen dhe të vendosim për gjërat më të rëndësishme që duhet të bëjmë për ta realizuar atë:

- Një zhvillim ekonomik i qëndrueshëm, me më shumë vende të reja pune;
- Një zhvillim social i avancuar dhe mundësi të barabarta qasje për të gjithë;
- Mbrojtje dhe zhvillim të qëndrueshëm të mjedisit të burimeve natyrore dhe kulturore; dhe
- Një infrastrukturë e integruar dhe shërbime efikase për qytetarët.³⁰

Arsyjet e vazhdimet të zhvillimit të turizmit në Komunën e Istogut janë:

1. Ofrimi i hapësirave dhe objekteve turistike, si dhe i shërbimeve që plotësojnë kërkesat e popullsisë vendase, atyre që punojnë dhe atyre që vizitojnë këto hapësira;
2. Promovimi i potencialit turistik të zonës, për të ndihmuar ekonominë lokale dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të zonës;
3. Plotësimi i kërkesave të veçanta për sport dhe rekreacion në lokacione të përshtatshme;
4. Krijimi i zonave turistike tërheqëse dhe të sigurta për ata që jetojnë, punojnë dhe vizitojnë këto zona; dhe
5. Mbështetja dhe rritja e mundësive për rekreacion informal dhe të qetë në pjesë të qeta të zonave turistike.³¹

4.3. Trashëgimia kulturore e Komunës së Istogut

Territori i Komunës së Istogut është shtëpia e një pasurie të trashëgimisë materiale, shpirtërore dhe kulturore. Kjo zonë është pjesë e krahinës etnografike të Podgurit, e cila ka qenë e banuar që në epokën parahistorike. Varret e shumta tumash të periudhës dardane, mbetjet e qyteteve antike dhe autostradave, si dhe një sasi e konsiderueshme e mbetjeve arkeologjike të zbuluara janë dëshmi e kësaj. Nga periudha e neolitit të vonë (mijëvjeçari i 6-të p.e.s. - sëpatë stralli e gjetur në Rakosh), shenjat më të hershme të banimit të njerëzve në këtë rajon datojnë që sot. Ndonëse, shpellat e shumta në Kosovë nuk janë studiuar tërësisht, duket se ato kanë shërbyer si zona banimi për njerëzit e Paleolitit dhe Mezolitit (parashikohet që më shumë kërkime në

³⁰ Sejfiqaj, O., Kuqi, B., & Shehu, E. (2023). Tourism and sustainable development opportunities in the Municipality of Istog-Republic of Kosovo.

³¹ Po aty

shpella të japin këto lloj gjetjesh). Bazuar në një kulturë relativisht të begatë dhe një numër të madh vendbanimesh të epokës së ardhshme, kërkimet në këtë drejtim vlerësohen të favorshme. Njerëzit u interesuan për qendrat arkeologjike në vitet 1800. Budaj Arpad ishte personi i parë që shkoi në një ekspeditë arkeologjike gjatë Luftës së Parë Botërore. Në vitet 1960 dhe 1970 u morën vendime të veçanta për mbrojtjen e 14 monumenteve të rëndësishme kulturore. Në vitin 2000, Sahar Rassam, një arkitekt që punon për Kombet e Bashkuara, udhëhoqi një anketë për të kontrolluar gjendjen e 49 kullave në Komunën e Istogut. Në vitin 2002 kanë bërë një listë me të gjitha gjërat e rëndësishme kulturore në Komunën e Istogut. Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës në Gjakovë ka gjetur 116 vende të rëndësishme historike në këtë zonë. Këto përfshijnë ndërtesa të vjetra si: kishat, xhamitë dhe kullat, si dhe mjete të lashta si: mullinj dhe sharra. Në vitin 2005, një grup arkeologësh eksploruan Komunën e Istogut dhe zbuluan rreth 30 vende të tjera antike, duke treguar se njerëzit kanë jetuar në këtë zonë për një kohë shumë të gjatë.³²

Komuna e Istogut ka gjithsej 14 xhami, një (1) është shkatërruar dhe pesë (5) janë dëmtuar në konfliktin e vitit 1999. Të gjitha janë rikonstruktuar pas konfliktit dhe janë ndërtuar dy (2) të reja. Të gjitha janë funksionale. Ekziston një (1) kishë katolike në Gurrakoc/Đurakovac dhe është funksionale. Janë gjithsej nëntë (9) kisha ortodokse serbe, një (1) është shkatërruar pas konfliktit të vitit 1999 dhe është rindërtuar në periudhën 2001-2003, një është (1) dëmtuar pas konfliktit të vitit 1999 dhe më tej në trazirat e marsit të vitit 2004 dhe është rikonstruktuar në periudhën 2007-2008, ndërsa tre (3) mbeten të dëmtuara/djegura dhe jofunksionale që nga konflikti i vitit 1999, dhe një (1) është e pranishme brenda mbetjeve të një kompleksi arkeologjik mesjetar. Tre (3) nga nëntë (9) kishat ortodokse serbe klasifikohen si Zona të Veçanta Mbrojtëse: Manastiri i Gorioçit, Manastiri i Virgjëreshës së Shenjtë të Hvosno-s dhe Kisha e Shën Nikollës. Gjithsej, 64 objekte të trashëgimisë kulturore (arkeologjike dhe arkitekturore) në komunën e Istogut janë të përfshira në listën e vendeve nën mbrojtje të përhershme/përkohshme të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.³³

³² Kurtaj, P. (2020). Zhvillimi i Turizmit në Komunën e Istogut. Universiteti i Pejës: Pejë

³³ Organization for Security and Co-operation in Europe -OSCE. (2018). Municipal Profile 2018 Pejë/Pec Region, Istog/Istok

KAPITULLI V

5. TURIZMI-STUDIM RASTI “KOMPANIA TROFTA”

5.1. Historiku dhe lokacioni i Kompanisë “Trofta”

Kompania “Trofta” u zhvillua në vitet 1950-1960, në fillim është njohur për kultivimin e peshkut të troftës dhe më vonë në fund të viteve 1970 dhe fillim të viteve 1980 duke shtuar shërbimet hoteliere. Ajo drejtohej ishte një Ndërmarrje Shoqërore që më vonë apo në vitin 2004 edhe është privatizuar, kur i ishte shitur një pronari privat për 2,012,002 euro. Kompania kishte 50 punëtorë dhe ishte në gjendje të keqe financiare para se të privatizohej. Kompleksi “Trofta”, i cili përfshin një hurdhe peshku, hotel dhe restorant, ka një sipërfaqe prej 5 hektarësh, ku dy prej tyre janë hektarë me sipërfaqe ujore, ndërsa pjesa tjetër përfshin ndërtesa, parking dhe lulishte. Pas shitjes dhe kalimit nga një ndërmarrje shtetërore në ndërmarrje private, zotit Ismail Bytyqi pronari i kësaj kompanie, investoi shumë para dhe mund, që kompania “Trofta” të bëhej shumë e suksesshme në Kosovë.³⁴

Kompania “Trofta” është një kompani në Kosovë që ka filluar aktivitetin e saj nga themeluesi Ismail Bytyqi, i cili bleu një ndërmarrje sociale dhe këtë e ktheu si biznes të tij. Kompania është blerë për mbi 2 milionë euro. Pas blerjes, z. Bytyqi është dashur të shpenzojë shumë para për rregullimin e hotelit dhe objekteve të tjera, sepse ato ishin të vjetra dhe të dëmtuara. Ai gjithashtu ndërtoi gjëra të reja si një restorant dhe parkingje.³⁵

Kompania “Trofta” është një vend i veçantë në Kosovë sepse e prezanton një fermë të madhe për peshkun e troftës. Është në një zonë të bukur pranë disa maleve të larta. Ferma është rreth 5 hektarë e madhe dhe ka shumë pishina të mbushura me peshq të madhësive të ndryshme. Një kompleks hotelesh me gjashtë bungalot (kampe) ndodhet pranë disa pishinave që janë një atraksion popullor. Pishinat furnizohen me ujë të pastër dhe të ftohtë nga burimi i quajtur Istog. Pas mbushjes së pellgjeve, uji derdhet në lumin e Istogut.³⁶ Tanimë, kompania “Trofta” është njëra ndër kompanitë më të njohura në Kosovë, kjo është arritur fal punës dhe angazhimit të të gjithë stafit, si dhe vullneti i pronarit të kësaj kompanie është i pakufi dhe i pakrahasueshëm

³⁴ TROFTA. (2024). Historiku, Trofta-Istog. E marrë nga: <https://trofta.com/>

³⁵ TROFTA. (2024). Trofta-Istog. E marrë nga: <https://trofta.com/>

³⁶ TROFTA. (2024). Lokacioni, Trofta-Istog. E marrë nga: <https://trofta.com/>

nëse vendoset në raport me punën e kompanive të tjera të kësaj fushë. Një sukses i në kompanie që nuk do të arrohet kurr dhe e cila ka ngritur edhe turizmin e kësaj zone

5.2. Aktivitetet dhe veprimtaritë e kompanisë “Trofta”

Kompania “Trofta” ushtron disa aktivitete të cilat janë paraqitur specifikisht më poshtë. Veprimtaria e parë e “Troftës” është prodhimi apo kultivimi i peshkut. Në sektorin e prodhimit kompania kujdeset për rritjen e një lloji të veçantë peshku që quhet “trofta Kaliforniane”. Fillimisht, kanë filluar duke ndihmuar që peshqit të riprodhohen dhe më janë siguruar që të rriten në madhësinë e duhur për shitje. Kjo procedurë ndodh kryesisht gjatë muajt të dimrit (dhjetorit dhe janarit), kur uji është në temperaturën e duhur për çelin e vezëve të peshkut (10°C). Duhet rreth 15 muaj që peshku të rritet në madhësinë që njerëzit mund ta blejnë, që është rreth 350 deri në 400 gram. Peshku ka nevojë për ushqim dhe kujdes të mirë për t’u rritur mirë. Peshku i troftës që kultivohet nga kompania është me të vërtetë i cilësisë së mirë, sepse uji në të cilin jeton është i pastër dhe i ftohtë, si dhe u japim ushqim të veçantë nga Danimarka. Janë rreth 30 persona që punojnë në këtë pjesë të kompanisë gjatë gjithë vitit, të cilët edhe janë të punësuar të përhershëm.

Veprimtaria tjetër e kompanisë është asortimenti i produkteve në kuadër të këtij aktiviteti kompania ka një numër të madhë të produkteve. Para se kompania t’u shitej pronarëve të rinj, ata shisnin peshk të freskët vetëm në hotele dhe restorante në Kosovë. Por, pasi pronarët e rinj morën përsipër, ata e bënë peshkun edhe më të mirë duke e pastruar dhe pakeluar në një mënyrë të veçantë. Ata gjithashtu filluan të shesin gjëra të reja si peshk i tymosur, fileto peshku dhe biftekë peshku. Produktet e kompanisë janë: stek peshku, peshku i freskët, peshku i pastruar, peshku i gjallë peshku i vakumuar, peshku i terur dhe file peshku.³⁷ Kompania “Trofta” ofron edhe shërbime hotelierie në të cilën edhe vendosen turistët e huaj dhe të vendit, kjo kompani është qendër e pritjes së trajnimeve nga institucionet publike dhe nga organizatat tona dhe ato ndërkombëtare, shërbimet e restaurantit janë të një niveli shumë të lartë dhe me produkte aq cilësore dhe aq të këndshme, kjo cilësi ngritet fal shërbimit perfekt nga stafi i kompanisë në fjalë. Kompania ka edhe restaurantin që ofrojnë ushqime të cilat janë të përgatitura nga kompania me shumë precizitet dhe cilësi, kjo ka ndikuar që kjo kompani të ketë sa më shumë turistë dhe të jetë ndër kompanitë më me emër apo reputacion në vendin tonë.

³⁷ TROFTA. (2024). Veprimtaritë, Trofta-Istog. E marrë nga: <https://trofta.com/>

5.3. Tregu dhe të arriturat e kompanisë “Trofta”

Peshku i troftës dhe gjërat e prodhuara prej tij shitet më së shumti në tregun vendas, i cili është i pajisur me produkte cilësore. Kërkesa për produktet e troftës ka ardhur duke u rritur ndër vite dhe mund t’i gjeni në shumë markete në Kosovë. Disa tregje kanë edhe peshk të gjallë për shitje, falë pishinave të vogla për t’i mbajtur. Gjithashtu, produktet e troftës gjenden në restorante dhe hotele, disa prej të cilave kanë rezervuarët e tyre të peshkut për të mbajtur peshk të gjallë për klientët e tyre. Plasmani i këtyre produkteve është si në vijm:

- Hotelet;
- Qytetarët;
- Marketet;
- Restorantet; dhe
- Fermat e peshkut.³⁸

Kompania “Trofta” ka investuar në kompaninë e tyre shumë para, rreth 2 milionë euro. Ata mund të prodhojnë rreth 400 tonë peshk në një vit, e cila shumë na tregon se prodhimi i peshkut është shumë i madhë. Ata kanë mbi 100 punëtorë që ndihmojnë në prodhimin e peshkut dhe në punën në hotel. Gjatë verës, ata punësojnë edhe më shumë punëtorë për të ndihmuar me hotelin. Ata më së shumti shesin peshkun dhe produktet e tyre të peshkut në zonën e afërt, por disa i dërgojnë edhe në Maqedoni. Në Kosovë ka ferma të tjera që prodhojnë edhe peshk, por “Trofta” prodhon shumë më tepër se ato kompanitë tjera.

Kompania “Trofta” bashkëpunon edhe me kompanitë tjera që e prodhojnë peshkun, si brenda qytetit të Istogut ashtu edhe në qytetet tjera për të ndihmuar njëri-tjetrin. Ata u japin peshk disa kompanive në këmbim që marrin ushqim peshku. Ata gjithashtu ndihmojnë me turizmin dhe sportin në qytetin e Istogut duke dhuruar para dhe duke mbështetur projekte si rregullimi i rrugëve dhe financimi i një klubi futbolli. “Trofta” është një ndihmë e madhe në komunitetin tonë dhe njihet si bujare dhe mbështetëse.³⁹

³⁸ TROFTA. (2024). Tregu, Trofta-Istog. E marrë nga: <https://trofta.com/>

³⁹ Kurtaj, P. (2020). Zhvillimi i Turizmit në Komunën e Istogut. Universiteti i Pejës: Pejë

5.4. Shërbimet e kompanisë “Trofta”

Shërbimet e ofruara nga Hotel “Trofta” mund të kategorizohen në grupe të shumta, ose në mënyrë alternative, në sektorë të shumtë, të cilët janë:

- Hotel apo restoranti veror;
- Salla e dasmave;
- Restoranti i shërbimeve për kafe dhe pije;
- Kultivimi i peshkut; dhe
- Sallën e konferencave.

Kompania “Trofta” ofron shërbime hoteliere, prej të cilave është e njohur për shumë njerëz, veçanërisht mikpritja dhe komoditetet që ofron për mysafirët. Në vijm të gjitha shërbimet e kompanisë janë paraqitur në me fotografi dhe me shpjegime përkatës. Më lartë përmendem se kompania ofron shërbime hotelierie për gjithë pjesëmarrësit në trajnime dhe për turistët.



Figura 1: Hotel “Trofta”

Burimi: (Hotel Trofta, <https://www.facebook.com/trofta> (24.03.2024))

Në figurën më lartë shohim pamjen e hotelit “Trofta”, nga figura kuptojmë se ky hotel ofron shërbime me cilësi shumë të lartë dhe komoditet nga më të mirë në treg për gjithë vizitorët dhe turistët vendos dhe të huaj.




Figura 2: Hotel “Trofta”

Burimi: (Hotel Trofta, <https://trofta.com/hotel-home/> (24.03.2024)

Hoteli i “Troftës” është më shumë se një vend për të qëndruar, është hotel krenarë për historinë dhe traditat e tyre, të cilat janë të rrënjosura thellë në komunitetin lokal. Hoteli është një dëshmi e identitetit kulturor të rajonit dhe mikpritjes së tij të ngrohtë. Ky hotel i mundëson turistët të zhyten në historinë dhe traditën e rajonit të Istogut gjatë qëndrimit të tyre. Nga arkitektura mahnitëse mesjetare e deri te kuzhina e shijshme lokale, ka kaq shumë për të eksploruar dhe zbuluar. Hoteli është i vendosur në rrëzë të maleve të mrekullueshme të Istogut në Kosovë, Hotel “Trofta” ofron një arratisje unike nga jeta e qytetit. Me bukuri natyrore mahnitëse në pragun vendor, hoteli ofron bazën e përsosur për të eksploruar Rajonin e Istogut.

Dhomat dhe suitat e këtij hoteli janë të bollshme dhe të dizajnuara, duke u bazuar në komoditetin e klientëve, duke ofruar një pushim paqësor pas një dite aventure. Në restorantin e këtij hoteli, kompania shërben me një kuzhinë të shijshme vendase dhe ndërkombëtare, të përgatitura me përbërës të freskët, me burim vendas. Më poshtë në (fg.3) është e paraqitur dhoma standarde që gjenden në hotelin “Trofta”, nga fotografia shihet se dhoma është me standarde të hotelit me pesë yje dhe shumë komode për vizitorët e këtij hoteli.⁴⁰

⁴⁰ TROFTA. (2024). Trofta-Istog. E marrë nga: <https://trofta.com/hotel-home/>




Figura 3: Hotel “Trofta”

Burimi: (Hotel Trofta, <https://www.facebook.com/trofta> (24.03.2024))

Në shërbim tjetër që kryen kompania “Trofta” janë shërbimet e restaurantit. Ky restaurant është destinacioni më i mirë i kuzhinës për të gjithë adhuruesit e ushqimeve të detit. I ndodhur në qytetin malor të Istogut, Kosovë, restoranti është i njohur për pjatat e tij të shkëlqyera të bëra nga troftat më të freskëta të marra direkt nga çerdhet tona. Në Trofta, besojmë në ofrimin e miqve tanë me një përvojë të jashtëzakonshme ngrënieje. Kuzhinierët tanë të aftë kombinojnë teknikat tradicionale dhe moderne për të krijuar pjata të shijshme dhe mahnitëse nga aspekti vizual. Ky restaurant krenohet me atë që përdorin, pra përbërësit e cilësisë më të lartë dhe për përkushtimin e tyre është ndaj qëndrueshmërisë, ata sigurohen që të furnizohen me të gjithë përbërësit tanë me përgjegjësi. Pavarësisht, nëse jeni duke kërkuar për një darkë romantike për dy ose një festë në grup, Restoranti “Trofta” ofron një atmosferë tërheqëse që i lenë vizitorët me kujtime të paharrueshme. Duhet që t’i bashkohemi dhe të kënaqemi këtu me një aventurë kulinare, si askund tjetër.⁴¹ Në (fig.4) është paraqitur pamja kryesore e restaurantit të hotelit të “Troftës”.

⁴¹ TROFTA. (2024). Trofta-Istog. E marrë nga: <https://trofta.com/restaurant/>



Figura 4: Restaurant “Trofta”

Burimi: (Hotel Trofta, <https://trofta.com/restaurant/> (24.03.2024)

Në figurën (5) është paraqitur teraca 1, që është pjesë e shërbimeve të restaurantit. Kjo terracë ka një kapacitet prej 120 vendesh, ofron një ambientë të përsosur për një përvojë të paharrueshme gjatë të ushqyerit. Kjo terracë është e vendosur mes pamjeve të bukura të kopshteve të harlisura dhe peizazheve të qeta, terraca ofron një arratisje të këndshme ku mysafirët mund të kënaqen me kuzhinën e shkëlqyer, gjatë kësaj kohe edhe shijojnë erën e butë.⁴²

⁴² TROFTA. (2024). Trofta-Istog. E marrë nga: <https://trofta.com/restaurant/>



Figura 5: Terraca 1 “Trofta”

Burimi: (Hotel Trofta, <https://trofta.com/restaurant/> (24.03.2024))

Në figurën (6) është paraqitur terraca 2 e cila poashtu përdoret për shërbimet e hotelierisë dhe restaurantit. Në këtë terracë, madhështia takohet me gastronominë. Me një kapacitet për të akomoduar 250 vizitorë, Terrace 2 ofron një ambient që të lë pa frymë duke u shoqëruar me kuzhinë të këndshme. Ofron një pamje mahnitëse, ndërsa krijon kujtime të paharrueshme gjatë ngjarjeve private të secilës familje, turisti vendor apo të huaj.⁴³



Figura 6: Terraca 2 “Trofta”

Burimi: (Hotel Trofta, <https://trofta.com/restaurant/> (24.03.2024))

⁴³ TROFTA. (2024). Trofta-Istog. E marrë nga: <https://trofta.com/restaurant/>

Në figurën (7) është paraqitur terraca 3 e cila poashtu përdoret për shërbimet e hotelierisë dhe restaurantit. Kjo terracë ka një hapësirë mahnitëse për ngrënieje në ambient të hapur me një kapacitet prej 250 vendesh. Në këtë terracë përjetohet përvoja përfundimtare e ngrënies në afresk, ndërsa klientët zhyten në një ambient të gjallë të rrethuar nga pamje që të lë pa frymë.⁴⁴



Figura 7: Terraca 3 “Trofta”

Burimi: (Hotel Trofta, <https://trofta.com/restaurant/> (24.03.2024))

Kompania “Trofta” ofron edhe shërbime për sallën e konferencave për takimet e ndryshme për liderët institucionale, për takimet e rëndësishme edhe nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare. Sallat e konferencave të “Troftës” janë moderne të cilat janë krijuar për të përmbushur të gjitha nevojat e vizitorëve për ngjarjet e tyre. Hapësirat moderne dhe të gjithanshme mund të konfigurohen për t’iu përshtatur në çdo ngjarjeje, qoftë kjo një konferencë biznesi, seminar apo ndonjë mbledhje tjetër shoqërore. Synimi i “Troftës” është t’ju ofrojnë klientëve përvojën më të mirë të mundshme të ngjarjeve, dhe për këtë arsye, sallat e konferencave janë të pajisura me Wi-Fi me shpejtësi të lartë dhe pajisjet më të fundit audio-vizuale.⁴⁵ Në (fig.8) është paraqitur pamja e sallës së konferencës së kompanisë “Trofta”.

⁴⁴ TROFTA. (2024).Trofta-Istog. E marrë nga: <https://trofta.com/restaurant/>

⁴⁵ TROFTA. (2024).Trofta-Istog. E marrë nga: <https://trofta.com/conference-halls/>




Figura 8: Salla e konferencës “Trofta”

Burimi: (Hotel Trofta, <https://trofta.com/conference-halls/> (24.03.2024)

Një shërbim tjetër që ofron kompania e “Troftës” është kultivimi i peshkut dhe shpërndarja e tyre në marketet e ndryshme të Kosovës. Kapacitetet dhe objektet e përpunimit të Troftës përfaqësojnë kulmin e akuakulturës së qëndrueshme dhe përpunimit të ushqimeve të detit. Akuakulturistët, ekspertë dhe teknikat moderne të përpunimit sigurojnë që kompania të prodhojë Toftën Rainbow të cilësisë më të lartë me një kapacitet prodhimi vjetor prej 400 tonësh. Vendi ku kultivohet peshku kombinon metodat tradicionale të mbarështimit me kërkimet më të fundit shkencore për të rritur troftën e shëndetshme dhe të shijshme në një mjedis natyror. Objektet e përpunimit përdorin teknologji dhe teknika të fundit për të pastruar, filetuar dhe paketuar peshkun në mënyrë të përsosur, duke siguruar që klientët të marrin vetëm ushqimet e detit më të freskëta dhe më të shijshme.⁴⁶Në (fig.9) është paraqitur Trofta Rainbow.

⁴⁶ TROFTA. (2024).Trofta-Istog. E marrë nga: <https://trofta.com/conference-halls/>



Figura 9: Kultivimi i Rainbow

Burimi: (Hotel Trofta, <https://trofta.com/hatchery/> (24.03.2024)

Një prej kultivimeve më të rëndësishme të peshkut është “Trofta e tërë”. Kategoria e kultivimit “Whole Trout” ofron një shumëllojshmëri produktesh Rainbow Trout të freskëta dhe të rritura në mënyrë të qëndrueshme. Nga trofta e gjallë deri te opsionet e freskëta dhe të papërpunuara, peshqit tanë rriten me kujdes dhe rriten në një mjedis natyror për të siguruar shëndetin dhe cilësinë e tyre. Trofta jonë e pastruar me mbeturina dhe trofta e pastruar e paketuar me vakum ofrojnë mundësi të përshtatshme dhe të lehtë për t'u përgatitur për kuzhinierët dhe kuzhinierët e zënë në shtëpi. Në Trofta, ne jemi të përkushtuar të ofrojmë produkte deti të cilësisë më të lartë që janë të shëndetshme dhe të shijshme.⁴⁷ Në fig (10) është paraqitur përmes kësaj fotografie se si duket peshku i kultivuar për shpërndarje.

⁴⁷ TROFTA. (2024). Trofta-Istog. E marrë nga: <https://trofta.com/hatchery/>



Figura 10: Kultivimi i Troftës i tëri

Burimi: (Hotel Trofta, <https://trofta.com/hatchery/> (24.03.2024)

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në kuadër të këtij punimi është shpjeguar në detaje të gjitha aspektet që ndërlidhne me turizmin dhe trashëgiminë kulturore në përgjithësi, sepse dyjat këto mes vete janë shumë të gërshetuara, të cilat edhe mundësojnë edhe zhvillimin e turizmit. Nga punimi kuptuam se kultura dhe trashëgimia, përmes vlerave, besimeve, artit, monumenteve, ndërtimeve dhe elementëve të tjerë përfaqësojnë identitetin dhe integritetin kombëtar të njerëzve. Ai u lejon kombeve të kuptojnë historinë e tyre të kaluar dhe identitetin personal. Trashëgimia është një element i rëndësishëm për turizmin. Ndërsa, turizmi ofron mundësi të mëdha për zhvillimin ekonomik. Ai krijon vende pune, forcon ekonominë lokale, kontribuon në zhvillimin e infrastrukturës lokale dhe mund të ndihmojë në ruajtjen e mjedisit natyror, pasurive dhe traditave kulturore, si dhe në uljen e varfërisë dhe pabarazisë.

Nga punimi poashtu kuptuam se turizmi është një faktor esencial në zhvillimin ekonomik të një vendi, në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe në zhvillimin dhe performancën e kompanive të vogla të mesme që merren me shërbime, bujqësi, prodhim dhe tregti. Turizmi në Komunën e Istogut është shumë i rëndësishëm sepse i ndihmonë këtij vendi që t'i paraqet në pah gjitha vlerat natyrore dhe historike, dhe kjo ndikon që edhe të tjerët ta njohin historinë dhe bukurinë e atij vendi. Një prej vendeve pikante që ka ndikuar në zhvillimin e turizmit në Komunën e Istogut padyshim është edhe hoteli dhe restoranti "Trofta" që ushtron veprimtarinë e tij në Istog. Kjo kompani është shumë e njohur në vendin tonë e cila ofron shërbime për klientët që nga viti 2004 kur është privatizuar.

Kjo kompani ofron shërbime hotelierie dhe të restorantit nga më cilësorët në Kosovë, bënë kultivimin e peshkut që në të njëjtën kohë edhe shpërndan ato në tregun e Kosovës për shitje, kompania pranon shumë turisë dhe një pjesë e madhe dormuese e organizatave dhe institucioneve shtetore kryejnë trajnime në këto hotel, duke bërë hotelin me më reputacion në vend. Për t'i ngritur vlerat e këtyre që veç sa u përmenden duhet ndërgjegjësimi i bashkësisë lokale për zhvillimin e një kulture më të lartë turistike, të sigurohet një bashkëpunim i mirëfilltë me komunën dhe investitorët në këtë vend, të krijohen mundësi sa më të mira për investitorët për t'i investuar pasuritë e tyre në Istog dhe ta bëjnë një qendër shumë të mirë për vizitorët, sidomos ata ndërkombëtarë.

Turizmi është një mundësi e shumë e mirë për ndërkombëtarët për të mësuar një kulturë të re, por gjithashtu krijon shumë mundësi për qytetarët vendas. Ai u lejon bizneseve të rinj të

krijojnë produkte dhe shërbime të reja që nuk do të ishin të qëndrueshme vetëm për popullatën lokale të banorëve. Për më tepër, banorët përjetojnë përfitimet që vijnë nga turizmi që ndodh në vendin e tyre. Kjo kuptojmë një investim më i mirë për Istogun do të ndikonte që ende të ngritet edhe kompania “Trofta”, është mekat që mos të shihen nga të huajt bukuritë e këtij restoranti dhe hoteli.

Rekomandimet:

Rekomandimet kryesore të këtij punimi janë:

- Për të rritur ndërgjegjësimin dhe promovimin e rëndësisë së zhvillimit të turizmit në Komunën e Istogut;
- Duhe të hartohet një politikë më e mirë për të tërhequr turistë ose për të zhvilluar sektorin e turizmit në të ardhmen;
- Duhet të zhvillohen dhe kordinohen praktikrat e duhura menaxheriale për kujdesin ndaj trashëgimisë kulturore në Komunën e Istogut;
- Krijimi i i iniciativave lokale të përshtatshme dhe të qëndrueshme të turizmit dhe trashëgimisë në Komunën e Istogu; dhe
- Duhet të zhvillohet dhe inkurajohet një vlerësim i plotë, dizajni dhe planifikim i një projektit të integruar me plan shumë të saktë për menaxhimin e turizmit për kompaninë “Trofta” të Komunës së Istogut.

REFERENCAT

7th Diversity Matters. (2014). *A Forum On Preserving Culture And Heritage, Mimar Sinan University Of Fine Arts. Preserving Culture And Heritage Through Generations*. Istanbul, Turkey.

[Http://Amf.Net.Au/Library/Uploads/Files/Diversity_Matters_Forum_Overview_And_Theme_Summaries_2014.Pdf](http://Amf.Net.Au/Library/Uploads/Files/Diversity_Matters_Forum_Overview_And_Theme_Summaries_2014.Pdf).

Bassey, B. E. (2015). Transforming the Nigeria tourism industry through tourism entrepreneurial development. *African Journal of Business Management*, 9(15), 569-580.

Candela, G., & Figini, P. (2012). *The economics of tourism destinations*. In Candela, G & Figini, P. (Eds.). *The Economics of Tourism Destinations* (pp. 73-130). Berlin Heidelberg, Springer.

Condratov, I. (2013). E-tourism: Concept and evolution. *Ecoforum Journal*, 2(1), 10.

Cunha, L. (2012). *The definition and scope of tourism: A necessary inquiry*.

Dogru, T., & Bulut, U. (2018). Is tourism an engine for economic recovery? Theory and empirical evidence. *Tourism Management*, 67, pp. 425–34.

Doka, Dh. & Draçi, B. (2002), vepër e cituar, f.10-11.

Doka, Dh., & Draçi, B. (2002). *Gjeografia e turizmit*. Sh.b. e Librit Universitar, Tiranë, f. 9-10.

Gashi, M. (1986). *Bazat e turizmit, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore* (ish-KSAK). Prishtinë, f. 9-20, 42.

EU/CoE Support to the Promotion of Cultural Diversity. (2015). *Istog-Support to the Promotion of Cultural Diversity Local Economic Development component*. PCDK.

Gadve, P. A. (2017). A Study the Impact of Tourism Development on Local Business Community. *International Journal of Research in Management, Economics and Commerce*.

Avdyli, G. (2022). *Kosovo's Cultural Heritage: Social and Economic Importance*. JMU Scholarly Commons.

Halimi-Statovci, D. (2020). et al, vepër e cituar, 2020, f. 245-249.

Hall, M., & McArthur, S. (1996). *The Human Dimension of Heritage Management: Different Values*. Different Interests, Different Issues, 2-21.

Hooper, G. (2016). *Heritage And Tourism In Britain And Ireland*. Glasgow (UK): Palgrave Macmillan.

- Hooper, G. (2016). *Heritage And Tourism In Britain And Ireland*. Glasgow (UK): Palgrave Macmillan.
- Ivanov, S., & Webster, C. (2007). Measuring the Impact of Tourism on Economic Growth. *Tourism Economics*, 13(3), 379–388.
- Kadiu, E. (2013). *Ekonomi Turizmi* (butimi i dytë, sh.b). “Argeta-LMG”, Tiranë, 176.
- Kurtaj, P. (2020). Zhvillimi i Turizmit në Komunën e Istogut. Universiteti i Pejës: Pejë.
- Mansfeld, Y., & Winckler, O. (2008). The role of the tourism industry in transforming a rentiert to a long-term viable economy: The case of Bahrain. *Current Issues in Tourism*, 11(3):237–67.
- Marin, D. (1992). Is the export-led growth hypothesis valid for industrialized countries? *Review of Economics & Statistics*, 74(4), pp. 678–88.
- Mukhtar, R. (2019). Toward Socially Sustainable Tourism: The Impact of Tourism on SMEs And Livelihood Development At Tourism Destinations In Bahawalpur Pakistan. *Sustainable Business and Society in Emerging Economies*, 1(1), 43-54.
- Ntibanyurwa, A. (2006). Tourism as a factor of development. *WIT Transactions on Ecology and the Environment*, 97.
- Organization for Security and Co-operation in Europe -OSCE. (2018). *Municipal Profile 2018 Pejë/Pec Region, Istog/Istok*.
- Reçica, F. & Millaku, B. (2011). *Ekonomia E Turizmit/Tourism Economy*. Prishtina: The Authors.
- Richtscheid, K. (2011). *The Use of Cultural Heritage in Economic and Human Development: A Comparison of Built Heritage Projects in Morocco and British Columbia*.
- Sejfiqaj, O., Kuqi, B., & Shehu, E. (2023). *Tourism and sustainable development opportunities in the Municipality of Istog-Republic of Kosovo*.
- Timothy, D. J. & Nyaupane, G. P. (2009). *Cultural Heritage And Tourism In The Developing World: A Regional Perspective*. London And New York: Routledge.
- TROFTA. (2024). *Historiku, Trofta-Istog*. E marrë nga: <https://trofta.com/>
- TROFTA. (2024). *Lokacioni, Trofta-Istog*. E marrë nga: <https://trofta.com/>
- TROFTA. (2024). *Tregu, Trofta-Istog*. E marrë nga: <https://trofta.com/>
- TROFTA. (2024). *Trofta-Istog*. E marrë nga: <https://trofta.com/>
- TROFTA. (2024). *Veprimtaritë, Trofta-Istog*. E marrë nga: <https://trofta.com/>
- TROFTA. (2024). *Trofta-Istog*. E marrë nga: <https://trofta.com/conference-halls/>
- TROFTA. (2024). *Trofta-Istog*. E marrë nga: <https://trofta.com/hatchery/>
- TROFTA. (2024). *Trofta-Istog*. E marrë nga: <https://trofta.com/hotel-home/>

TROFTA. (2024). *Trofta-Istog*. E marrë nga: <https://trofta.com/restaurant/>

UN-Habitat Kosovo. (2015). *Local Environmental Action Plan Istog*.